



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 17.07.2018
Dokument parlamentar

R A P O R T

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË LIGJIN NR. 8378,
DATË 22.7.1998 "KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË
NDRYSHUAR”.**

Drejtuar: Seancës plenare

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi në mbledhjen e datës 10.07.2018 dhe 17.07.2018, në parim, nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar”.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator deputeti Pjerin Ndreu.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim vjen si propozim i deputetit Pjerin Ndreu në mbështetje të neneve 81 pika 1, 83, pika 1, të Kushtetutës.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT

Ky projektligji ka për qëllim amendimin e pikë 3 të nenit 127 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar nisur nga shqetësimet e shtetasve kosovarë, emigrantëve, por dhe shtetasve të huaj, si drejtues mjetesh, që udhëtojnë në një numër shumë të madh në Shqipëri, veçanërisht gjatë periudhës së verës.

III. ÇËSHTJET KRYESORE QË TRAJON PROJEKTLIGJI

Neni 1 i projektligjit ndryshon pikën 3 të nenit 127 duke shtuar dy pika të reja 3/1 dhe 3/2.

Konkretisht, propozohen formulimet si më poshtë:

"3. Lejedrejtimi pezullohet nga organi epror i agjentit të policisë që ka tërhequr lejedrejtimin dhe për lejedrejtimit e lëshuara nga një shtet i huaj, nga organi përgjegjës i qeverisjes vendore të vendit ku është kryer shkelja, sipas pikes 1 të këtij neni. Ky i fundit ia njofton masën e marrë autoritetit kompetent të shtetit që e ka lëshuar lejedrejtimin dhe e shënon, kur kjo është e mundur, në dokumentin e drejtimit të mjetit.

311. Kundër masës së pezullimit të lejedrejtimit lejohet ankim, brenda 20 ditësh, tek organet përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Kjo drejtori merr masa brenda 30 ditëve në vijim. Kur ankesa gjykohet e drejtë, të interesuarit i kthehet lejedrejtimi.

312. Lejedrejtimi pezullohet nga organi epror i agjentit të policisë që ka tërhequr lejedrejtimin dhe për lejedrejtimit e lëshuara nga një shtet i huaj, pezullimi i parashikuar në dispozitat e këtij neni konvertohet në pagesën e një shume që është sa dyfishi i masës administrative maksimale të parashikuar për dispozitën e shkelur. "

Nga zbatimi në praktikë i pikës 3 të nenit 127 të Kodit Rrugor kanë lindur vështirësi dhe pengesa. Kjo pikë e këtij neni është amenduar edhe në vitin 2011, por përsëri zbatimi i saj në praktikë nuk ka siguruar një normalitet të punës për organet zbatuese të ligjit dhe në mjaft raste janë konstatuar edhe elemente korruptive.

Propozimi për dyfishim të sanksionit me masë administrative në "këmbim" të mospezullimit të lejedrejtimit për drejtuesit e mjeteve me lejedrejtimi të lëshuar nga një shtet i huaj, do të jetë një masë lehtësuese për drejtuesit e mjeteve dhe do të ketë një impakt mjaft pozitiv për drejtuesit e mjeteve nga Kosova, të cilët transitojnë në Shqipëri çdo fundjavë dhe sidomos për sezonin turistik. Gjithashtu, impakt pozitiv ndryshimi do të ketë edhe për drejtuesit e mjeteve joshqiptare me kombësi të huaj, të cilët do të ndiejnë "shtrëngesën" në pagesën e një mase sa dyfishi i masës administrative maksimale të parashikuar për shkeljen e kryer.

Amendimi i propozuar do të ndikojë drejtpërdrejt në eliminimin e shfaqjeve korruptive dhe të perceptimit negativ që ekziston në publik për Policinë Rrugore, duke ofruar një alternativë për drejtuesin e mjetit në marrjen sa më shpejt të lejës së drejtimit dhe duke e ndërgjegjësuar atë në mospërsëritjen e kundravajtjes.

Në nenin 2 është përcaktuar hyrja në fuqi e projektligjit.

Projektligji, si projektligj joqeveritar, nuk ka ndikim në buxhetin e shtetit.

IV. DISKUTIME NË KOMISIONIN PËR SIGURINË KOMBËTARE

Projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar” u prezantua nga deputeti nismëtar Z.Pjerin Ndreu.

Gjithashtu, të ftuar në Komisionin e Sigurisë ishin Zv.Ministri i Punëve të Brendshme Z.Julian Hodaj dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Rrugore Z.Mitat Tola.

Në fjalën e tij Z.Ndreu u shpreh se ndryshimi në fjalë është i domosdoshëm për arsye të situatës së identifikuar në zbatimin e kësaj dispozite. Dispozita aktuale është mjaft e komplikuar pasi patentat duhet të kalojnë një kalvar të gjatë deri në momentin e mbërritjes së saj në dorën e kundravajtësit, konkretisht nga Policia e Shtetit në Prefekturë, në Ministrinë e Jashtme, në Konsullatë tek vendi ku jeton kundravajtësi. Personat e penalizuar janë më së shumti emigrantët e në vecanti shtetasit kosovare e maqedonas. Në praktikë ka ndodhur që për shkak të bllokimit të patentës të një emigranti, këtij të fundit i është dashur të lërë vendin e punës, deri në humbjen e saj Ndaj u pa i domosdoshëm ky ndryshim që shpesh herë është bërë edhe shkak për korrupsion duke vënë shërbimin nën presion dhe duke iu ofruar para nën dorë, për të mos lejuar pezullimin e patentës.

Gjithashtu Z.Ndreu u shpreh si ishte i hapur për cfaredolloj propozimi tjetër për të pasur një zgjidhje sa më optimale duke shmangur edhe spekulimet e fundit në media ku thuhet se kjo bëhet vetëm për efekte financiare.

Më nismën u bashkuan edhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Rrugore dhe Zv.Ministri i Brendshëm. Ky i fundit, shtoi se për ta bërë sa më efektive këtë nismë do ishte e nevojshme edhe ndryshimi në nenin 201 të Kodit Rrugor, ndërhyrje kjo që nuk u aprovua nga komisioni me arsyetimin se nisma të tilla duhet të paraqiten në komision sipas procedurës së përcaktuar dhe pas një studimi më të detajuar.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komision u vlerësua ndërmjarrja e kësaj nisme ligjore duke evidentuar rëndësinë që ka ky ndryshim për emigrantët që vijnë në vendin tonë. Gjithashtu, nga anëtarë të komisionit u shtruan edhe disa çështje si p.sh. sa është dyfishi i gjobës dhe nëse ky ndryshim e justifikonte shkelejen e kryer duke mos stimuluar shkeljen e ligjit, apo nëse ky ndryshim ishte një diskriminim për shtetasit shqiptarë vendas etj.

Pas shumë diskutimeve u vendos që në nenin 127 të Kodit Rrugor të bëhen këto shtesa si më poshtë:

Konkretisht, neni 1 të riformulohet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 127 të bëhet shtesa si më poshtë:

Pas pikës 3 të shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

3.1 Pezullimi i lejëdrejtimit të lëshuar nga një shtet i huaj, në rastet kur kundravajtësi jep pëlqimin, konvertohet me pagesën e një shume që është sa dyfishi i masës administrative maksimale të parashikuar për normën e shkelur.

V. PËRFUNDIME

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni për Sigurinë Kombëtare, duke vlerësuar rëndësinë e këtij projektligji, me shumicën e votave, miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi duke ja kaluar për miratim seancës plenare.

RELATOR

KRYETARE

PJERIN NDREU

ERMONELA VALIKAJ (FELAJ)